



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 7630 Prot.

Lezhë, më 20 . 04 . 2021

VENDIM

Nr. 76 Datë 19 . 04 . 2021

PËR
DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VKB VKB NR.46, DATË 13.11.2019 "PËR
MIRATIMIN E NIVELIT TË TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, LEHTËSIRAT
FISKALE, STRUKTURAT E VJELJES SË TYRE DHE ATO TË VENDOSJES SË
PENALITETEVE NDAJ KUNDRAVAJTËSVE",

Mbështetur në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 9, pika 1/1.3, gërma "b", neni 35, pika 4, neni 54, gërma "f" në ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

VENDOSI :

1. Të bëjë ndryshim të afatit të kryerjes së pagesave për taksat dhe tarifat vendore, për kategoritë e taksapaguesve " Biznes" dhe "Institucione", vetëm për vitin 2021, si më poshtë:
 - a. Taksa mbi pasurinë, afati i pagesës datë 31 Maj.
 - b. Taksa mbi Tabelën, afati i pagesës data 31 Gusht
 - c. Tarifa për shfrytëzim të hapësirës publike, për qëllime biznesi, afati i pagesës data 31 Gusht.
 - d. Tarifa për shfrytëzim të hapësirës publike, për qëllime parkimi, të miratuara si Stacione Qëndrimi, afati i pagesës data 31 Gusht.
 - e. Tarifa për Shërbimet Publike, kësti i parë, afati pagesës data 31 Maj, kësti i dytë, afati i pagesës data 31 Gusht.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes dhe i shtrin efektet e tij vetëm brenda vitit 2021.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
ERNEST RAKAJ

